



EGC
Leonard Hoxhaj
Drejtore
Prizren

Ankesa Nr. 2015/39 KPM vs EGC
Ref:1504/359/LEG/hzg

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2015/39 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër Operatorit Kabllor EGC (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse me datën 6 qershor 2013, është pajisur me licencë të KPM-së. Me marrjen e Licencës Pala Përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. KPM, me datën 19 dhe 23 shkurt 2015, ka pranuar dy ankesa të parashtruara kundër Palës Përgjegjëse lidhur me bartjen e kanalit Top Channel. Njëra ankesë është parashtruar nga bartësi i të drejtës për kanalit Top Channel për territorin e Republikës së Kosovës, operatori kabllor IPKO, ndërsa ankesa tjetër është parashtruar nga operatori kabllor Elektron me seli në Zhur.
3. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, ka analizuar provat materiale të parashtruara nga operatori kabllor IPKO dhe Elektron dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bartur kanalit Top Channel pa të drejtë për transmetim.
4. KPM, duke u bazuar në ankesat e pranuar, me datën 18 mars 2015, përmes një kërkesë ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse, që në afat prej pesë (5) ditësh ta sjellë marrëveshjen valide me të cilën dëshmon se ka të drejtën e bartjes së kanalit Top Channel.

5. KPM me datën 23 mars 2015, ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes të cilës ka informuar që nuk posedon të drejta të autorit për bartjen e kanalit Top Channel dhe se nuk është duke bërë bartjen e këtij kanali.
6. KPM, bazuar në shkeljen e Kushteve dhe Termet e Përgjithshme të Licencës nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 24 mars 2015, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veprojë në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, në të kundërtën KPM do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
7. KPM, pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, me datën 27 mars 2015, ka pranuar edhe një përgjigje nga Pala Përgjegjëse. Pala Përgjegjëse pretendon së ankesat janë bërë duke falsifikuar materialet, pasi që ata nuk e bartin kanalën Top Channel. Por, pranon që mund të ketë ndodhur për shkak të problemeve teknike.

Analiza Ligjore

8. KPM, bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës i cili përcakton se:

“I Licencuari nuk do të ritransmetoj asnjë program pa marrëveshje valide mbi të drejtën e autoriale. Bartja e kanaleve të programeve pa të drejtë autoriale përbën shkelje të rëndë të Kushteve dhe Termeve të Licencës dhe shkelje të tilla rezultojnë më revokim të licencës”.

9. Bazuar në raportin e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që ka bartur kanalën Top Channel pa të drejtë autoriale.
10. Komisioni i KPM-së duke u bazuar në raportin e monitorimit gjënë se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, pasi që ka dështuar të sjellë marrëveshjen përmes të cilës dëshmon se posedon të drejtën për bartjen e kanalit Top Channel.
11. Bazuar në raportin e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje të dërguar nga KPM përmes së cilit i është bërë me dije se është në shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, nuk ka sjellë dëshmi se posedon të drejtën për bartje të kanalit Top Channel.
12. KPM, ka analizuar me kujdes provat materiale të parashtruara nga palët ankuese. Në kuadër të provës materiale (CD) vërehet se Pala Përgjegjëse ka bartur kanalën Top Channel, fakt ky që dëshmohet përmes kanalit INFO i cili ndihmon në identifikimin e të licencuarit. Pretendimi i Palës Përgjegjëse se provat materiale janë të falsifikuara është i pa bazuar.
13. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura Komisioni i KPM-së vlerëson se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 2, paragrafi 1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që ka bërë bartjen e kanalit Top Channel pa të drejtë autoriale.

Vendimi


14. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 2, paragrafi 1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
15. Komisioni, vendosi që në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, Pala Përgjegjëse të sanksionohet me gjobë në shumën prej 3,000.00 (tremijë) euro për shkelje të nenit 2, paragrafi 1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

E drejta për Ankesë

16. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
17. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



28.04.2015

datë